

KOMUNIKATË PËR MEDIA

6 gusht, 2007

Publikimi i listave të punëtorëve përshpejtohet nga gushti

PRISHTINË – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) shpall se, që nga fillimi i këtij gushti do të këtë përshpejtim në publikimin e listave të punëtorëve. Pesë deri në gjashtë lista punëtorësh do të publikohen çdo javë.

Në javët e fundit AKM ka qenë e angazhuar në procesin e nënshkrimit të kontratave me gazeta ditore, proces ky i cili është finalizuar me sukses.

AKM do të publikoj listat e punëtorëve tri herë në javë në gazetat ditore Kosovare si “Koha Ditore” dhe “Zëri”, ndërsa do të publikoj gjithashtu në gazetën Serbe “Kurir” dhe gazetën Malazeze “Vijesti”.

Listat e punëtorëve do të publikohen gjithashtu ne web faqen e AKM-së dhe do të jenë në dispozicion në gjuhën Shqipe dhe Serbo-Kroate.

Deri tani, AKM ka shpërndarë 15,588,153.00 Euro, si pjesë e njëzet përqindëshit, punëtorëve nga 50 Ndërmarrjeve Shoqërore .

AKM në bashkëpunim me NSH-të dhe BSPK-në ka përgatitur 35 lista punëtorësh të cilat janë të gatshme për publikim, duke filluar këtë jave.